VENDIM
Nr. 82, datë 16.12.2005

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT METODIK PËR VLERËSIMIN NGA ERE TË INVESTIMEVE QË KRYEJNË TË LICENCUARIT NË HIDROCENTRALET ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 5 MW, SI DHE NË H/C E SMOKTHINËS

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa f, 9 dhe 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 16.12.2005, pasi shqyrtoi draftin e "Udhëzuesit metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5 MW, si dhe në H/C e Smokthinës", të përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzuesit metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5 MW, si dhe në H/C e Smokthinës" (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit të njoftojë të gjithë të licencuarit që janë objekt i zbatimit të kësaj metodike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

UDHËZUES METODIK PËR VLERËSIMIN NGA ERE TË INVESTIMEVE QË KRYEJNË TË LICENCUARIT NË HIDROCENTRALET ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 5 MW, SI DHE NË H/C E SMOKTHINËS

Autoriteti

Ky udhëzues metodik hartohet në mbështetje të autoritetit që gëzon ERE në bazë të neneve 8, pika 2 germa f, dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Baza ligjore

Ky udhëzues metodik është hartuar duke u bazuar në legjislacionin ekzistues në fushën e investimeve, ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", udhëzimin nr.2 të Këshillit të Ministrave, datë 8.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", vendimin e Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.09.1994 "Për tarifat e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit", udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën" dhe legjislacionin në fushën e tatimeve.

Përmbajtja

I. Qëllimi dhe fusha e zbatimit
II. Përcaktime për strukturën e investimeve
III. Hapat kryesorë dhe përgjegjësitë në kryerjen e një investimi
IV. Dokumentacioni i nevojshëm shoqërues sipas procedurave për realizimin e investimit
V. Dispozita të fundit

I. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky udhëzues metodik ka për qëllim të ndihmojë personelin teknik të ERE-s, si dhe atë të të licencuarve në lidhje me njohjen dhe zbatimin e kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, për mbajtjen dhe dokumentimin hap pas hapi të dokumentacionit ligjor, që vërteton kryerjen e investimeve në hidrocentralet e vogla me fuqi të instaluar deri në 5MW, si dhe hidrocentralin e Smokthinës. Ky udhëzues do të shërbejë:

a) gjatë ushtrimit të kontrolleve, për të gjykuar dhe vlerësuar investimet e raportuara nga të

licencuarit;

b) për të vlerësuar sa më realisht, në periudhat e aplikimit nga të licencuarit, çmimet e shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga H/C.

II. Përcaktime për strukturën e investimeve

Investimet e kryera në hidrocentrale shërbejnë kryesisht:

- për ndërtime të reja;
- për rikonstruksione, zgjerime dhe përshtatje të objekteve ekzistuese.

Në strukturën e investimeve, për realizimin e ndërtimeve të reja, rikonstruksioneve, zgjerimeve dhe përshtatjeve të H/C ekzistuese parashikohen investimet për:

- studime dhe projektime, duke filluar që nga studimi i leverdisshmërisë së ndërtimit të veprës;
- makineri dhe pajisje (teknologjike dhe të tjera);
- punimet e ndërtimit;
- mbikëqyrja dhe kolaudimi përfundimtar.

III. Hapat kryesorë dhe përgjegjësitë në kryerjen e një investimi

Sigurimi i projekteve dhe preventivave

Punimet për realizimin e investimeve do të realizohen në bazë të projekteve të zbatimit, të cilat, bazuar në nenin 5 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", do të hartohen nga një organizatë projektuese shtetërore ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë përkatëse, në bazë të kontratave të hartuara midis palëve.

Projektuesi, si një element i rëndësishëm i projektimit, duhet të hartojë dhe preventivat përkatës, me qëllim që të përcaktojë shpenzimet e domosdoshme për kryerjen e punimeve. Preventivat dhe llogaritjet në to do të bëhen në mbështetje të plotë me projektet e ndryshme të ndërtimit, elektrike, mekanike etj., të zbatimit. Këto konsiderohen dokumentet bazë, nëpërmjet të cilave përcaktohet vlera e plotë e investimit që do të kryhet.

Hartimi dhe llogaritjet e një preventivi do të bëhen konform modeleve dhe rregullave të përshkruara në udhëzimin nr.2 të Këshillit të Ministrave datë 8.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

Vlerat respektive të studimeve dhe projektimeve nuk mund të jenë më të larta se ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.09.1994 "Për tarifat e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit".

Projektuesi përfshin, si një pjesë të projektit hartimin e listës së furnizimit me pajisje, makineri dhe materiale teknologjike, së bashku me specifikimet teknike dhe sasitë.

Projektuesi mban përgjegjësi për projektet, preventivat dhe specifikimet teknike. Për projektet e ndërtimit të objekteve me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, do të bëhet oponencë teknike e projektit, e cila kryhet nga organizma të përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

Kontraktimi dhe lëvrimi për makineri, pajisje dhe materiale teknologjike

Bazuar në listat respektive të furnizimit të pajisjeve, makinerive dhe materialeve teknologjike dhe në specifikimet përkatëse teknike, investitori do të kontraktojë për prodhimin dhe furnizimin e tyre. Mallrat që vijnë nga jashtë do të shoqërohen sipas përkatësisë me dokumente shoqëruese:

Faturë (Proforma invoice), lista e paketimit (Packing List), certifikatë e origjinës (Certeficate of origine). Për pajisjet dhe makineritë duhet të ekzistojnë kompletet e vizatimeve, raportet e testimit, manualet dhe instruksionet e mirëmbajtjes dhe të përdorimit.

Kur blerjet sigurohen brenda vendit si dokument shoqërues do të jetë dhe fatura tatimore.

Për pajisjet dhe makineritë të cilat janë nxjerrë jashtë vendit për riparim dhe janë kthyer përsëri të riparuara duhet të ekzistojnë dokumentet e eksportit të përkohshëm, si dhe dokumentet e kthimit përsëri së bashku me certifikatat e cilësisë.

Kryerja e punimeve të ndërtimit

Në punimet e ndërtimit sipas udhëzimit nr.2, datë 8.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" kreu I , do të kuptojmë dhe do të vlerësohen:

a) Punimet e ndërtimit të parashikuara në projektet ndërtimore, përfshirë dhe rikonstruksionet, zgjerimet dhe përshtatjet (për H/C shih pikën 5 të udhëzimit të mësipërm);

b) Punimet teknologjike dhe të montimit, të parashikuara në projektet teknologjike dhe që përbëhen nga:

- punimet teknologjike;
- punimet e montimit.

Për vlerësimin e punimeve teknologjike dhe të montimit, përcaktimi të bëhet sipas germës B të udhëzimit të sipërpërmendur.

Punimet e ndërtimit do të kryhen nga persona fizikë ose juridikë, privatë a publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë përkatëse sipas llojit të punimeve që do të kryhen.

Ndërmjet investitorit dhe sipërmarrësit të punimeve do të nënshkruhet kontrata për kryerjen e punimeve ku do të përcaktohen kushtet lidhur me zbatimin e punimeve konform projekteve të zbatimit dhe respektimit të kushteve teknike, cilësisë së materialeve në përputhje me standardet, afatet e përfundimit të punimeve etj.

Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi

Mbikëqyrja e punimeve kryhet mbështetur në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", nëpërmjet një personi/ persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencat përkatëse të jashtme ose nga personeli i investitorit të ngarkuar për mbikëqyrjen e realizimit faktik të punimeve në sasi e cilësi sipas kushteve respektive të projektimit, zbatimit dhe të kontratës të punimeve, si dhe për miratimin e dokumentacionit themelor, si:

- Situacione punimesh, prova të pjesshme të veprës e deri në kolaudimin përfundimtar.

Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi i punimeve në faza të ndryshme të punimeve, si dhe ato përfundimtare kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Situacioni është dokumenti me rëndësi që pasqyron punën e kryer në fakt, por të parashikuar në projektpreventiv. Kur situacioni paraqitet me ndryshime nga preventivi (të diktuara gjatë procesit të zbatimit), krahas situacionit kërkohet të jetë edhe dokumenti i pranimit të këtij ndryshimi nga projektuesi dhe investitori.

Në përfundim të kolaudimit të veprës, mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në kontratën dhe të gjithë dokumentacionet e tjera, përcakton vlerën përfundimtare të investimit të realizuar. Kjo vlerë i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe njoftohet investitori për vlerën përfundimtare të detyrueshme për të paguar.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm shoqërues sipas procedurave për realizimin e investimit

r.	Emërtimi i dokumentit	Nënshkruesit
1.	Projektet e zbatimit: - Kontrata investitor-projektues dhe vlefta e bërjes së projektit; - Preventivat e punimeve.	Projektuesi Investitor–projektues Projektuesi
2.	Lista e furnizimit me pajisje, makineri dhe materiale teknologjike, së bashku me specifikimet teknike: - Kontratat e furnizimit sipas përkatësisë; - Faturat (Proforma invoice); - Lista e paketimit (Packing List); - Certifikatë e origjinës (Certeficate of origine); - Fatura tatimore (për blerjet në vend); - Dokumentet e eksportit (për riparimet që kryhen jashtë vendit);	Projektuesi Investitor-furnizues Furnizues/prodhuesi Prodhuesi Prodhues /dogana Furnizuesi/prodhuesi Investiotori/ dogana
3.	Kontrata për kryerjen e punimeve	Investitor-sipërmarrës
4.	Kontrata për mbikëqyrjen e punimeve	Investitor-mbikëqyrës
5.	Kontrata për kolaudimin e punimeve sipas përkatësisë së punimeve	Investitor-kolaudator
6.	Procesverbal i kolaudimit të punimeve	1. Kolaudator-2.Sipërmarrës- 3. Mbikëqyrës Projektues -investitor
7.	Situacionet përfundimtare të punimeve	Sipërmarrës -mbikëqyrës
8.	Faturat e likuidimit të punimeve (sipas përkatësisë)	Investitor

V. Dispozita të fundit

Amendamente të udhëzuesit metodik

Ky udhëzues metodik është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Hyrja në fuqi

Ky udhëzues metodik hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.